



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:110379

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06376700

KPPP.nr. 665/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Ugrija Commmerc Sh.P.K., me numër unik identifikues 810497455 dhe seli në Prishtinë, rr. “Vëllezërit Fazliu”, kundër debitorit Mega Center Sh.P.K., me numër unik identifikues 810010984 dhe seli në Lluzhan, Komuna Podujevë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 427/24, i lejuar me datë 28.03.2024, nga Përbaruesi Privat Eset Murati me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Mega Center Sh.P.K., ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 427/24, i lejuar me datë 28.03.2024, nga Përbaruesi Privat Eset Murati.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 427/24, i lejuar me datë 28.03.2024, nga Përbaruesi Privat Eset Murati, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ugrija Commmerc Sh.P.K., mbi bazën e dokumenteve të besueshme – Faturës nr. 000207/18, e datës 20.01.2018; Faturës nr. 001166/18, e datës 07.04.2018; Faturës nr. 001647/18, e datës 12.05.2018; Faturës nr. 002226/18, e datës 30.06.2018; Faturës nr. 002628/18, e datës 28.07.2018; Faturës nr. 004306/20, e datës 23.11.2020; Faturës nr. 002176/21, e datës 07.06.2021; Faturës nr. 002996/21, e datës 02.08.2021; Faturës nr. 003118/21, e datës 09.08.2021; Faturës nr. 000277/22, e datës 24.01.2022; Faturës nr. 003892/22, e datës 29.08.2022; Faturës nr. 004906/22, e datës 24.10.2022; Faturës nr. 005300/22, e datës 14.11.2022; Faturës nr. 005799/22, e datës 12.11.2022; Faturës nr. 000074/23, e datës 09.01.2023; Faturës nr. 000600/23, e datës 06.02.2023; Faturës nr. 003237/23, e datës 19.06.2023;

Faturës nr. 005135/23, e datës 18.09.2023, si dhe; Faturës nr. 005675/23, e datës 16.10.2023, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 427/24, të datës 28.03.2024, me të cilin është urdhëruar debitori Mega Center Sh.P.K., që t'ia paguajë kreditorit shumën prej EUR 4,921.55, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se në propozimin për përmbartim nuk është paraqitur në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendja faktike, sepse nga provat e paraqitura vërtetohet se shumica e faturave janë paguar. Ndërsa, ka shtuar se fillimisht është dashur që të bëhet barazimi i kartelave e jo të iniciohet procedura përmbartimore dhe të krijohen shpenzime pa nevojë, andaj gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar dhe urdhrin përmbartimor ta anuloj.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se urdhri për përmbartim është lejuar në përputhje me nenin 29 të LPP-së, në bazë të faturave si dokumente të besueshme dhe të përshtatshme për përmbartim. Më tej, ka theksuar se debitori nuk ka paraqitur prova me të cilat do të mbështeste pretendimet e tij sipas nenit 69.4 të LPP-së, andaj qëllimi i tij është zvarritja e pagesës së borxhit. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, "*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*", ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*". Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: "*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*".

Gjykata vlerëson se përmbartuesi privat ka lejuar urdhrin përmbartimor mbi bazën e dokumenteve të besueshme, përkatësisht faturave të përshkuara si në hyrje të arsyetimit të këtij aktvendimi, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi

3 të LPP-së, për arsye se janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor janë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori dhe rrjedhimisht rezulton se debitori ka qenë i njoftuar me përmbajtjen dhe lartësinë e faturave, ndërsa të njëjtat nuk i ka kundërshtuar.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinale.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit se shumica e faturave objekt përmbarimi janë paguar, mirëpo të njëjtat i gjeti të pabazuara pasi që debitori nuk ka bashkangjitur asnjë provë për t'i mbështetur këto pretendime ashtu siç kërkohet me nenin 69.4 të LPP-së, i cili përcakton se *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të paraqitura nga debitori në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 665/24, datë 30.10.2024

Gjyqtari

Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate